



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin.

PROCESVERBAL

Tiranë, më 10.07.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Niko Peleshi – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me shqyrtimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” (*Komision për dhënie mendimi*)

2. Shqyrtimi dhe votimi i projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9636, datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” (*Komision për dhënie mendimi*)

Marrin pjesë:

Niko Peleshi , Halil Jakimi, Besnik Baraj, Ilir Beqaj, Rrahman Rraja, Eglantina Gjermeni, Andrea Marto, Tatiana Nurçe, Ilir Ndraxhi, Arben Pëllumbi, Robert Bitri, Ardit Konomi, Dritan Bici, Halil Jakimi, Arlind Çaçani, Zef Shtjefni, Kujtim Gjuzi, Halit Valteri, Fadil Nasufi dhe Ilir Pendavinji.

Mungojnë:

Gjetan Gjetani, Lefter Koka dhe Nimet Musaj.

Të ftuar:

Mira Rakacolli - Zëvendësministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Antoneta Njehrrëna- Drejtore Juridike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Vjollca Braho – Kryeinspektore në ISHSH

Përparim Tushaj – Konsulent i “Japan Tobacco International” (JTI)

Armand Pëllumbi – Përfaqësues i “Aga Group”

Lorent Gordi – Përfaqësues i “Philip Morris International” (PMI)

Brunilda Bakiri – Përfaqësuese e “British American Tobacco” (BAT)

Fatmir Kazazi – Konsulent i pavarur i industrisë së duhan-cigareve

Bora Muzhaqi - Këshilltare e Jashtme e Ministrit të Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes

Raul Gonzalez- WHO Representative and Head of Country Office in Albania

Gazmend Bejtja- NPO, WHO Country Office Albania

Najada Skuka- interpreter/translator

HAPET MBLEDHJA

Niko Peleshi - Mirëdita!

Sot në rendin e ditës kemi për shqyrtim projektligjin: “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636 datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” i ndryshuar”. Relator është zoti Andrea Marto.

Të ftuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale kemi: zonjën Mira Rakacolli, zëvendësministre, drejtoreshën juridike Antoneta Njehrrrena dhe Vjollaca Brahon kryeinspektore.

Gjithashtu, të ftuar kemi edhe përfaqësues nga grupet e interesit, zotërinjtë Përparim Tushaj, konsulent i “Japon Tabaco International”, Armand Pëllumbin, përfaqësues i “AGNA Grup”, Florent Gordi, përfaqësues i “Filip Morris International”, Brunilda Bakiri përfaqësuese e “British American Tobacco”, Fatmir Kazazi, konsulent i pavarur i industrisë së duhan-cigareve, Bora Muzhaqi, këshilltare e jashtme në Ministrinë e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, zotin Raul Gonzales, përfaqësues i OBSH-së, si edhe zoti Gazmend Bejtja.

Në fillim do të flasë relatori, zoti Andrea Marto, më pas përfaqësuesit e ministrisë do të bëjnë prezantimin e projektligjit dhe më pas do të dëgjojmë pretendimet, rekomandimet dhe vërejtjet e përfaqësuesve të grupeve të interesit. Pastaj do të vazhdojmë me seancën e pyetje-përgjigjeve dhe në fund votimin.

Zoti Beqaj për procedurë.

Ilir Beqaj – Unë do të ftoja të gjithë kolegët deputetë për një moment reflektimi, duke propozuar të mos e marrim për shqyrtim këtë projektligj! Nuk kam asgjë me projektin, por fakti që ligji ekzistues shkelet në mënyrë të hapur nga vetë ne, në mënyrë pasive dhe aktive, për mendimin tim, nuk na jep të drejtën ta diskutojmë këtë projektligj. Le të angazhohemi të paktën që ne vetë jo vetëm në mjediset tona të punës, këtu ose edhe në sallën e seancës, kudo në jetën publike ta zbatojmë këtë ligj, pastaj, pas disa muajsh prove zbatimi, mund ta diskutojmë këtë projekt.

Së dyti, në vlerësimin tim, grupet e interesi nuk janë vetëm prodhuesit dhe tregtuesit, por edhe konsumatorët dhe pacientët, edhe ata që vuajnë nga pasojat në shëndet të produkteve të duhanit, madje dhe familjarët, të cilët detyrohen të paguajnë barrë sociale, psikologjike dhe financiare për sëmundjet e provuara tashmë fatale që sjell duhani.

Niko Peleshi - Po, zoti Baraj.

Besnik Baraj – Parimisht më duket i drejtë qëndrimi i kolegut, por nuk më duket racional, sepse, nëse do të ndjekim këtë parim, ne nuk duhet të bëjmë asnjë amendim për asnjë ligji, sepse në Shqipëri është e vështirë të ketë një ligj, i cili të zbatohet 100%. Kështu që nëse këto ndryshime i vlejnë ligjit themelor, unë them që duhet të bëhen.

Ilir Beqaj – Meqenëse m'u referuat, unë nuk thashë që ky ligj nuk zbatohet në Shqipëri, por ne vetë, në mënyrë demonstrative, nuk e zbatojmë këtë.

Niko Peleshi – Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – E filluam me një handikap, se zoti Beqaj është një ndër nismëtarët e ligjit dhe në Shqipëri një pjesë e madhe e qytetarëve e kanë mirëpritur ligjin, përjashtoj ata që kanë konflikt interesi. Është ulur pak përdorimi i duhanit dhe në këtë rast kuptohet që kompanitë e kanë problem, por, nëse është e vërtetë që në ambientet e Kryesisë së Kuvendit, nëpër zyra ka njerëz që pinë duhan, unë mendoj se ata nuk meritojnë të qëndrojnë aty fare. Por meqë qeveria socialiste para viteve '90 ka qenë e dhunshme, tani është bërë pak tolerante dhe e lejon këtë. Po të shoh njeri që pi cigare do t'ia marr, e do t'ia hedh.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Po, zoti Bici.

Dritan Bici - Unë shoh që ligji për ndalimin e duhanit ka krijuar efekte shumë të mira deri tani, krahasuar me kohën kur nuk kishte një ligj për ndalimin e duhanit. Tashmë në ambientet publike janë të rrallë ata që e shkelin ligjin, dhe them se ky ligj ka për t'u zbatuar 100%.

Unë jam dakord me zotin Beqaj që ne e shkelim vetë ligjin, kështu e parlamentit është vendi ku shkelet brutalisht ligji për ndalimin e duhanit, madje i kam thënë drejtoreshës së Trajtimit të Deputetëve që zbatimi i ligjit duhet të fillojë që këtu, por nuk jam për ta stopuar nismën që kanë sjellë këtu specialistët. Jam për t'i mbështetur ata.

Niko Peleshi - A ka ndonjë mendim tjetër? Nuk ka.

Atëherë, unë jam dakord me diskutimin dhe argumentimin që bëri zoti Baraj. Ky ligj nuk është i vetmi që nuk respektohet edhe nga deputetët, por deputetët nuk janë engjëj, por nuk janë as djaj.

Është e vërtetë që gjërat dhe fenomenet nuk rregullohen dot duke rregulluar ligjet, për shembull kujtoj kohën kur filloi zbatimi i ligjit të duhanit, para qeverisë socialiste dhe ishte një dështim. Bëhej një fushatë, pastaj lihej rrugëve dhe nuk ndodhte asgjë. Më pas zoti Beqaj ka qenë shumë aktiv, vetëm atëherë ndodhi një respektim i papritur dhe i pazakontë për shoqërinë tonë.

Nuk e di si vazhdon tani, në kafenenë e parlamentit është pirë vazhdimisht cigare. Unë kam bërë xhestin e duhur, kam një vit e gjysmë që e kam lënë duhanin, të na falin grupet e interesit, një konsumator më pak, por besoj se tani kemi detyrë shtetërore të diskutojmë për projektligjin.

Siç e tha edhe zoti Beqaj grupe interesi nuk janë vetëm tregtarët dhe prodhuesit, por edhe konsumatorët, por siç do ta dëgjojmë edhe nga zonja zëvendësministre ky projektligj ka kaluar në të gjitha fazat e detyrueshme për t'u konsultuar edhe me publikun e gjerë.

Kalojmë te prezantimi i relatorit, zotit Marto, dhe më pas fjalën e ka zëvendësministrja.

Andrea Marto – Faleminderit!

Synimi i ndryshimeve të propozuara në projektligjin “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, konsiston në mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit; në rritjen e monitorimit të duhanpirjes në Shqipëri; në sigurimin e mbrojtjes së shëndetit nga produktet e duhanit; në forcimin e rolit monitorues të inspektoratit përgjegjës për Shëndetësinë në lidhje me zbatimin e ligjit për mbrojtjen e shëndetit nga duhani.

Objektivi i politikës dhe efektet e saj, që synojnë të arrihen nëpërmjet ndryshimeve të propozuara, është reduktimi i përdorimit të produkteve të duhanit të popullatës në masën 35% te meshkujt dhe 4% te femrat brenda vitit 2021; reduktimi me 20% i ekspozimit të popullatës ndaj efekteve të dëmshme të duhanit brenda vitit 2021, reduktimi në 10 i aksesit të popullatës ndaj produkteve të duhanit brenda vitit 2021.

Ndryshimet që propozohen në këtë projektligj, konsistojnë në saktësimin e përkufizimit të duhanit dhe të nënprodukteve të tij si dhe përfshirjen në këtë kategori të produkteve të reja të duhanit, kjo bëhem me qëllim përfshirjen në kuadrin rregullator të çdo produkti ose nënprodukti duhani që është i dëmshëm për shëndetin e popullatës si dhe në forcimin e kontrollit të duhanit dhe shmangies së rasteve abuzive; në detyrimin e tregtuesve për të informuar Ministrinë e Shëndetësisë për hyrjen në treg të produkteve të reja të duhanit; në ndalimin e shitjes së paketave me numër të reduktuar cigaresh; në ndalimin e promocionit të fshehur nëpërmjet ngjyrave të logos së produkteve të duhanit dhe vendosjes së tyre në raftet e dukshme në kuadër të forcimit të kontrollit dhe të moslejimit të promocionit dhe marketimit të produkteve të duhanit, si një faktor që simulon përdorimin e tij; në ndalimin e përdorimit të cigareve elektronike në mjediset e mbyllura dhe aplikimin e të njëjtave rregulla si format konvencionale të duhanpirjes me synim mbrojtjen nga ekspozimi i pavullnetshëm ndaj produkteve të duhanit; në forcimin e masave

ndëshkuese në rast të moszbatimit të ligjit me synim forcimin e implementimit të ligjit dhe mbrojtjes së qytetarëve që ekspozohen.

Parashikohet një periudhë shtyrjeje për zbatimin e këtij ligji.

Unë bashkohem me shqetësimin e paraqitur nga zoti Beqaj dhe dua që edhe ne emrin tuaj ta falënderoj, sepse, nëse ligji i duhanit ka pasur sukses, ka ndodhur në kohën kur ministria drejtohej nga zoti Beqaj.

Sa për rastet që u përmendën këtu, unë mendoj se janë raste, por besoj se në pjesën më të madhe të republikës ligji zbatohet. Inspektorati duhet të jetë më i kujdesshëm dhe i përgjegjshëm edhe më shumë në detyrën e tij për të zbatuar ligjin. Shtesat që propozohen në ligj përafrohen edhe me direktivat e BE-së.

I ftoj kolegët t'i miratojnë ndryshimet në këtë projektligj!

Mira Rakacolli - Faleminderit!

Të nderuar deputetë, duhani është i vetmi faktor i eliminueshëm i atyre sëmundjeve të cilat janë përgjegjëse për zënien e vendit të parë në numrin e vdekjeve të popullsisë, për zënien e vendit të parë në sëmundshmëri dhe në invaliditet.

Po të flasim me gjuhën e shifrave, OBSH –ja referon që vetëm si rezultat i përdorimit të duhanit në vit në botë vdesin 7 milionë njerëz, nga të cilët rreth 900 mijë vlerësohen si përdorues pasiv. Nga kjo shifër kuptohet që lufta kundër duhanit është botërore, e të gjitha sistemeve shëndetësore e joshëndetësore që duhet të merret seriozisht nga politikbërësit.

Në frymën e kësaj lufte nën udhëheqjen e OBSH-së në vitin 2003 është nënshkruar Konventa botërore Kundër Duhanit, të cilën Shqipëria e ka nënshkruar 2 vjet më pas. Detyrimet që lindin nga kjo konventë janë bazë për ligjin, për ndryshimet ligjore në vazhdimësi. Ligji aktual ka qenë i suksesshëm, sepse si rezultat i masave dhe i përkufizimeve të bëra në atë ligj duhanpirja u pakësua dhe kjo dëshmohej jo vetëm në çmimin që u mor në vitin 2015 për luftën që ka bërë Shqipëria për mospërdorimin e duhanit, por, njëkohësisht, është përmendur në raportet e progresit që Komuniteti European ka shkruar.

Në vitin 2017 parlamenti i Shqipërisë ka nënshkruar dakordësinë me OBSH-në për realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm. Një nga këto objektiva, ai 3 A, flet për një botë pa duhan në vitin 2030. Kjo e vë qeverinë tonë edhe para një detyrimi për ta parë ende më me prioritet luftën për mospërdorimin e duhanit.

Studimet e fundit të bëra nga Instituti i Shëndetit Publik në vitin 2018 tregojnë se në Shqipëri vazhdon të mbetet i lartë niveli i duhanpirjes, sepse në meshkujt e moshës 30-50 vjeç 36% janë përdorues. Fatkeqësisht një në katër veta mendohet të ketë pasoja të rënda të vuajtjes së sëmundjeve kronike deri në vdekje.

Nga ana tjetër, gjatë këtyre viteve në tregun shqiptar janë prezent disa produkte që njihen si inovative të duhanit, siç është cigarja me ngrohje ose ajo elektronike, ashtu sikurse janë edhe produktet e nargjilesë ose shishes, të cilat nuk kanë ende një kuadër rregullator dhe është i argumentuar mirë dhe i provuar mirë, që edhe këto produkte janë mjaft të dëmshme për shëndetin dhe duhet të futen në një kuadër rregullator ligjor.

Këto janë arsyet pse Ministria e Shëndetësisë mori nismën për të propozuar ndryshimet në ligjin aktual.

Një ndër ndryshimet kryesore që prek ky ligj, siç e tha edhe deputeti relator, është përkufizimi i duhanit. Arsyeja është përcaktimi se produkte të duhanit nuk janë vetëm cigarja e zakonshme, por edhe produktet e reja inovatore.

Gjithashtu, përveç saktësimit për duhanin dhe cigaren elektronike, për të cilën ka pasur një debat shumë të gjerë, është edhe detyrimi për informimin e Ministrisë së Shëndetësisë për produktet e reja që futen në treg, me qëllim mbrojtjen e popullatës, sepse, nëse ministria nuk është e informuar, nuk kontrollon dot dhe në shumë raste këto produkte që futen si produkte të duhanit, ato produkte mund të kenë substanca të dëmshme për organizimin dhe shëndetin e njeriut.

Së treti, forcojmë masat për marketimin e produktit të duhanit. Në ligjin e sotëm promovimi për produktet e duhanit është i ndaluar, por ka edhe forma që nuk e bëjnë promovimin e duhanit të dukshëm, pra, jo me fjalë, por me mënyra të tjera, për shembull, në të gjitha supermarketet ku blejmë, te kasa jemi para një tablele ku janë të ekspozuara të gjitha llojet e paketave të duhanit, por jo dëmet e duhanit. Fëmijët dhe të gjithë ne jemi kështu të ekspozuar para dëshirës për ta provuar duhanin. Kjo është një formë e fshehur e bërjes së promovimit, e cila me këtë ligj është e ndaluar.

Së fundi, në këtë ligj të rëndësishme janë edhe sanksionet. Jemi të ndërgjegjshëm që për fenomenet jo të mira që ndodhin, të cilat i përmendi dhe deputeti Beqaj, që edhe ne vetë ndonjëherë nuk i respektojmë ato që shkruajmë në ligj, duhet të ketë sanksione. Nëse mendohet që një subjekt merr një gjobë të caktuar, por nëse e përsërit veprimin brenda 3 muajve gjoba do t'i dyfishohet

dhe nëse përsërit veprimin atëherë gjoba do t'i gjashtëfishohet dhe do të shkojë deri në heqje të licencës.

Të nderuar kolegë, këto ndryshime ne i kemi konsultuar gjatë me grupet e interesit, që kanë të bëjnë me prodhimin dhe me tregtimin e duhanit, por më shumë me grupet e interesit, të cilëve u preket shëndeti. Këto ndryshime i kemi konsultuar dhe jemi përpjekur që t'i ofrojmë me direktivën europiane. Këtë e diskutuam edhe dje në Komisionin e Integritetit.

Së fundi, ne mendojmë se ky është një ligj i mirë, i cili do të sjellë përmirësime në shëndetin e popullatës, kështu që ju ftoj ta miratoni!

Niko Peleshi - Zonja Braho.

Vjollca Braho - Faleminderit!

Desha të theksoj punën që është bërë në këtë periudhë nga Inspektorati i Shtetëror Shëndetësor. Shpeshherë futemi në ambiente ku konsumohet duhani dhe shikojmë që ka shkelje të ligjit. Unë e kam marrë këtë detyrë në fillim të muajit shkurt dhe në atë periudhë pashë se situata ishte jo e mirë. Pavarësisht se bëhej monitorimi për zbatimin e ligjit të duhanit, megjithatë kishte subjekte që e shkelnin atë. Nuk pihet më duhan në ambiente të mbyllura, por ambientet e jashtme janë kthyer në ambiente të mbyllura duke vendosur qese, vetrata, xhama, pra duke shkelur ligjin, pasi ligji lejon që vetëm 50% e ambientit duhet të jetë i hapur. Në këto kushte unë krijova taksforcën antikorruption për të parë punën që bën çdo drejtori rajonale. Vetëm për 6-mujorin e parë të vitit 2019 janë marrë 298 masa administrative kundrejt 143 masave administrative që ishin marrë në gjashtë mujorin e parë të vitit 2018. Pra, kemi një dyfishim të masave administrative.

Ne nuk kemi objektiv kryesor vetëm vendosjen e masave administrative, por kemi edhe njohjen e opinionit me ligjin. Në fillim të punës sime nga të gjitha subjektet u kërkuan mendime si duhej të ishte ambienti në të cilat konsumohej duhani.

Gjithashtu, desha të them se edhe me porosi të zëvendëskryeministrit, zoti Erion Braçe, kemi bërë dhe bëjmë vazhdimisht një kontroll dhe inspektim në të gjitha institucionet shtetërore, kemi marrë edhe masa administrative duke filluar nga tatimet, policia, hipoteka dhe në disa bashki. Masat në ligjin aktual janë 3 milionë lekë për subjektin që shkel ligjin, 50 mijë lekë për administratorin, i cili mban përgjegjësi për mospirjen e duhanit dhe 5 mijë lekë për personin, i cili pi duhanin në ambientet e mbyllura.

Me gjithë dyfishimin e masave që ne vendosim edhe pse shikojmë disa herë kontroll te subjektet dhe rivendosim masa, lind nevoja për ndryshimin e këtij ligji, prandaj kemi bërë

përshkallëzimin, sipas të cilit nëse një subjekt ka marrë një gjobë dhe në rast se brenda 3 muajve do të vendoset gjoba e dytë, sigurisht që kjo gjobë do të dyfishohet duke shkuar në 6 milionë lekë, dhe nëse për herë të tretë brenda vitit do të jetë me shkelje do të vendoset gjashtëfishi i kësaj gjobe, në 18 milionë lekë.

Prandaj, është i nevojshëm miratimi i këtij projektligji.

Inspektorati Shtetëror Shëndetësor, së bashku me taskforcën do të jetë në krye të kësaj pune, megjithëse Inspektorati ka një numër prej 200 inspektorësh.

Të gjitha ndryshimet ligjore do ta forcojnë më tej zbatimin e ligjit.

Niko Peleshi - Po, zoti Beqaj.

Ilir Beqaj – Në fakt, dua ta filloj me një përgëzim për ministrinë, për cilësinë e hartimit të projektligjit. Është hera e parë që ka një raport vlerësimi të ndikimit të plotë shkencor për të gjitha hapat dhe kjo cilësi projektligji ka kohë që nuk ka ardhur. Përgëzime!

Tani kam disa pyetje: në raportin e vlerësimit të ndikimit, kur flisni për objektivat thoni të reduktohet përdorimi i duhanit në popullatë në masën 30% për meshkuj dhe 4% te femrat brenda vitit 2021, unë dua të di sa është sot?

Gjithashtu, thoni se do të bëni dy reduktime një me 20% një me 10, unë dua të di sa është dhe sa do të shkojë?

Në lidhje me aktivitetin e Inspektoratit për vitet 2017- 2018 dhe gjashtëmujori i parë i vitit 2019, kam këtë seri pyetjesh: sa gjoba janë vendosur gjithsej vetëm për duhanin? Sa nga këto gjoba u janë vënë institucioneve publike? Sa nga këto janë vënë për individë dhe sa për administratorin ose subjektin? Sa janë rrëzuar në gjykatë? Sa është vlera e përfituar? A ka ndonjë gjobë të vënë nga institucionet e tjera që ligji i ngarkon me vendosjen e gjobave? Sa thirrje kanë ardhur në numrin 0800, ku denoncohen shkeljet e ligjit?

Nëse sot nuk është e mundur të kthehen përgjigjet, deri të premten të mund t'i kemi përgjigjet.

Niko Peleshi – Vazhdojmë me pyetje.

Halit Valteri - Në projektligjin e nxjerrë për konsultim, ju keni parashikuar që shitja e produkteve të duhanit të bëhet vetëm në pika të caktuara, por jo në çdo dyqan, sepse këtu jemi në vendin e çudirave, pasi ku shiten perimet, buka e bulmeti ka edhe një stendë cigaresh të të gjitha llojeve. Pse e keni hequr këtë variant dhe nuk e keni sjellë sot për ta miratuar? Sipas mendimit tim, por t'ia mbush mendjen edhe të 126 deputetëve, cigarja duhet të blihet me kartë identiteti.

Kompanitë e duhanit hedhin shumë para për reklama ose për të financuar aktivitete, prandaj të blihen makineta, siç i ka bota, ku cigarja të blihet me kartë identiteti. A e ul kjo simulimin e pirjes së duhanit? Nëse nuk ka në çdo market, në çdo dyqan ose tezgë të lagjes cigare të hapura dhe të pahapura, a e ul kjo pirjen e duhanit?

Së dyti, rritja e akcizës së duhanit ka rritur informalitetin. Ne shikojmë cigare pa pullë që shiten, që janë të pakontrolluara dhe mund të jenë të rrezikshme, mund të jenë të helmuara, të mykura, mund të kenë përbërje kimike. Si mund ta ndalojmë këtë? Çfarë masash ka marrë Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me ministritë e tjera për ta ndaluar këtë fenomen?

Me ngritjen e taskforcës, zonja Vjollca, keni rritur vetëm informalitetin, vetëm pjesën e gjobëvënies. Unë kam rastisur vetë në një lokal të zona e ish- Ekspozitës, nuk e njoh fare pronarin, kur erdhën inspektorët dhe terrorizuan njerëzit. Aty jashtë është, ka vendosur 2-3 plastmasë, por vetëm pse nuk i dha aq lekë, i vunë 3 milionë lekë gjobë. Ai zotëria e ankimoi në Gjykatën Administrative dhe e fitoi çështjen. Tani, ti mund të shkosh dhe t'ia vësh disa milionë gjobën, por vetëm rrit mundësinë e marrjes lekë nga inspektori, nuk ia çon buxhetit të shtetit.

Faleminderit!

Fadil Nasufi - Duke iu bashkuar pyetjeve që bëri zoti Beqaj dhe Valteri, unë doja të dija në këto tre vjet që ka hyrë ligji i duhanit në fuqi, a keni ndonjë informacion si është trendi i prodhimit të duhanit në vend ose importit që vjen? Pra, ka rënie?

Së dyti, unë jam nga ata njerëz që më bie telefoni kur vihen gjoba. Doja të dija, si e keni influencën për të dënuar ndërhyrjen për moszbatimin e ligjit?

Niko Peleshi – Po, zoti Gjuzi.

Kujtim Gjuzi – Së pari, dua të falënderoj mjeken, që është doktore e shkencave!

A ka Ministria e Shëndetësisë mekanizma për të monitoruar trendin e përdoruesve meshkuj dhe femra, që, në fakt, duken në rritje?

Niko Peleshi – A ka pyetje të tjera? Jo, nuk ka.

Atëherë, përfaqësuesit e ministrisë të japin përgjigjet dhe më pas të flasin përfaqësuesit e grupeve të interesit.

Mira Rakacolli – Po e filloj përgjigjen me pyetjen që bëri zoti Beqaj, në lidhje me të dhënat që ka ministria për përqindjen e duhanpirësve.

Sipas të dhënave që ne kemi rezulton që të rinjtë e përdorin në masën 14,5%, ndërsa femrat 6,7%, adultët e kanë 47% për meshkujt dhe 4,2% për femrat, ndërsa vetëm për cigaren meshkujt e përdorin 42%, ndërsa femrat 4%.

Sa u përket të dhënave të vitit 2018 deri në moshën 50 vjeç janë 36% e meshkujve dhe 4% femra.

Në lidhje me pyetjet e tjera, pse në variantin e parë e kishim që duhani të shitej në pika të autorizuara, ky ishte vizioni i ministrisë sonë, por pas konsultimeve që ne bëmë me grupet e interesit e gjykuam të parakohshëm dhe e lamë ta shihnim në një fazë të dytë.

Sa i përket akcizës, ne nuk jemi ministria përgjegjëse, prandaj nuk i kemi të dhënat për këtë gjë. Po kështu edhe për pyetjen për trendin e prodhimit të duhanit nuk jemi ministria që përmbledh këto të dhëna.

Vjollca Braho – Unë nuk i kam me vete të dhënat për pyetjet që bëri zoti Beqaj, prandaj sipas të dhënave operative, në vitin 2017 janë vendosur 312 gjoba, në vitin 2018, 193 gjoba dhe në gjashtëmujorin e parë të vitit 2019 janë vendosur 296 gjoba. Ndërsa të ndara se sa janë institucione shtetërore dhe subjektet, që kanë marrë gjoba për momentin nuk i kam, por do t'ju dërgojmë një memo.

Sa i përket pyetjes tjetër, që bëri zoti deputet, për subjektet që ne kemi kontrolluar dhe kanë qenë të mbuluara me qese ose xhama ose vetrata, në momentin që bëhet inspektimi dhe, siç e kemi të përcaktuar edhe me ligj, nëse ambienti është i mbyllur më shumë se 50%, është në shkelje të ligjit.

Halit Valteri – Unë e kisha të mënyra si po e bëni kontrollin, sepse po terrorizohen njerëzit, bizneset. Këta njerëz kanë investuar, pasi të bësh një verandë të duhen 10-15 mijë euro investim, ku 7-8 mijë euro është investim vetëm që klienti të vijë e ta pijë kafën aty. Kam parë vetë me sy një rast kur në një lokal të hapur kanë ardhur inspektorët dhe e kanë terrorizuar pronarin vetëm për t'i marrë para. Inspektorët e taskforcës, që ju përmendni, sa më të lartë ta kenë hapin e gjobës aq më të lartë e kanë ryshfetin që marrin. Duhet të themi atë që është. Për gjashtëmujorin e vitit 2019 thua që keni vënë 296 gjoba, shifër të cilën duhet ta ndajmë për gjysmë, sepse njërën gjobë e ka biznesi tjetrën e ka personi. Tani, në të gjithë Tiranën me 1 milion e 300 mijë banorë, ka 10 mijë kafene. Po inspektorët çfarë bëjnë? Ata dalin rrugës vetëm për t'i vënë gjoba biznesit në mënyrë private dhe jo shtetërore, sepse përndryshe buxheti i shtetit do të ishte mbushur vetëm nga gjobat

e duhanit. Kështu që ta themi miqësisht, edhe si deputet, kontrolloni më shumë inspektorët sesa bizneset!

Faleminderit!

Vjollca Braho - Faleminderit!

Unë mendoj se më mirë se të ma thoshit sot miqësisht, në këtë mbledhjeje të komisionit, nëse ju keni qenë dëshmitar atje dhe ka qenë një rast flagrant duhej të ishit lidhur me mua që të bënim denoncimin në prokurori. Nuk është gjë e mirë që e keni lënë për sot që ta thoshit në këtë tavolinë, aq më shumë për të dhënë shembullin tuaj si deputet për të çuar para drejtësisë të gjithë abuzuesit me detyrën. Unë nuk jam prapa çdo grupi inspektimi. Nëse ka raste flagrante, të denoncohen! Por gjobat e vëna gjatë gjashtëmujorit të parë të këtij viti tregojnë për punën e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor.

Nëse ka raste flagrante ju ftoj të gjithëve t'i denonconi, por jo të ngrihet tymnajë për veprimtarinë e disa personave.

Halit Valteri – Nuk dua të bëj replikë, por, nëse ju e merrni se unë po bëj tymnajë, atëherë ju kërkoj ndjesë dhe nuk flas më, por disa gjëra duhen thënë ku është vendi. Ju mos e merrni sikur unë thashë që nuk e ke bërë punën, ju e keni bërë punën shumë mirë, se keni vënë 300 gjoba. Bravo ju qoftë! Unë e kam shqetësimin te biznesi dhe jo tek inspektori. Po ju them shikojeni ligjin, shikojeni 50%-shin e mbylljes me plastmas dhe ndryshojeni këtë gjë, sepse biznesi duhet t'i krijojë kushte konsumatorit. Duke i vendosur gjoba, 3 milionë një herë, 6 milionë herën tjetër, dhe 18 milionë herën tjetër, pastaj t'i mbyllësh edhe biznesin, ju siguroj se nëse gjashtë muajt e ardhshëm do të bëhet kjo gjë, nuk do të ketë më shumë se 5 mijë biznese në Shqipëri.

Ilir Beqaj – Unë besoj se, nëse ne ia dalim që ligjin ta zbatojmë në mënyrë uniforme, nuk ka për të ndodhur asgjë. Këtë na e tregon eksperiencia europiane. Kështu është bërë në Gjermani dhe Itali. Ne na duhet të këmbëngulim te zbatimi uniform i ligjit, të mos krijojmë hapësirë për konkurrencë të pandershme. Praktikisht duhej që Inspektorati të ishte më proaktiv kur doli moda e plastmaseve, por një inspektor, bazuar në ligjin, i cili bazohet në një konventë të miratuar nga ky parlament në vitin 2004, e ka për detyrë ta zbatojë ligjin. Në konventë thuhet qartë që, nëse dy nga faqet janë të mbyllura edhe me plastamas, është ambient i mbyllur, nuk duhet ta përdorësh duhanin. Sigurisht duhet t'ua shpjegojmë bizneseve se çfarë nënkupton 50%-shi. Kështu është e shkruar, e kemi marrë nga ata që e kanë gjykuar kështu dhe përderisa ka funksionuar kudo, duhet të funksionojë edhe në Shqipëri.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të ketë edhe raste të tilla, por praktika tregon që jo.

Vjollca Braho – Të gjitha inspektimet bëhen online në sistem, janë të shoqëruara me fotografi. Në komision vijnë persona dhe subjekte, të cilët ankohen se kanë marrë leje nga bashkia për të bërë investime, por të jeni i bindur se nuk është vënë asnjë gjobë nëse ambienti ka qenë i hapur. Kur kanë shkuar inspektorët ambienti ka qenë i mbyllur, inspektimi është shoqëruar edhe me fotografi, në asnjë rast të kundërt nuk është vënë gjobë.

Niko Peleshi – Ju lutem, nuk zgjidhet gjithçka vetëm me ligj. Inspektori mund të jetë shumë korrekt, por shteti ligjor do të funksionojë kur të gjitha hallkat të rregullohen, sepse nuk bëhen të gjitha menjëherë.

Ju lutem, nga grupet e interesit, do të flasë kush?

Raul Gonzales- Zoti Peleshi, faleminderit që më keni ftuar në këtë komisionin!

Zonja zëvendësministre faleminderit!

Zonjës Manastirliu i jam mirënjohës.

Unë dëshiroj t'i referohem ligjit bazë, i cili është miratuar në vitin 2006, i cili ka qenë i mirë, sepse shikojmë që ka rënë duhanpirja. Po ashtu, dëshiroj ta krahasoj Shqipërinë me vendet e rajonit ku Shqipëria qëndron në mes të tabelës, pra është në një vend të mirë.

Kur shikojmë duhanpirjen në vendet në veri, jug, lindje, përfundim shohim se ato vende janë në krye të tabelës për përdorimin e duhanit. Kjo tregon se Shqipëria ka ecur mirë. Por ligji nuk është i gdhendur në gur, sepse rrethanat ndryshojnë. Ligji duhet t'i përshtatet nevojave të popullatës, sepse firmat dëshirojnë të prezantojnë produkte të reja dhe ligji duhet të jetë një gjë e gjallë, i cili të reflektojë të gjitha këto interesa. Do të biem dakord që përdorimi i duhanit shkakton kancerin. 7 milionë në vit vdesin nga përdorimi i duhanit, nga të cilët 6 milionë janë përdorues direkt të duhanit dhe 1 milion janë duhanpirësit pasivë. Kjo na jep idenë se sa duhet të ndërhyjmë. Në fakt, amendimet në projektligj janë në këto pika dhe këtu kemi dhënë edhe në këshillat tona. Përkufizimi i produkteve të duhanit duhet të ndryshojë. Vite më parë nuk i kemi pasur cigaret elektronike dhe as produktet me ngrohje të duhanit.

Si OBSH, rekomandojmë që këto produkte të reja të trajtohen në ligj, ashtu siç trajtohen produktet tradicionale të duhanit. Pse e themi këtë? Sepse kemi dy qasje në lidhje me përdorimin e produkteve të duhanit: njëri është dëmi, tjetri është adiksi, ti fillon dhe krijon varësi ndaj produkteve të duhanit.

Ka disa produkte të reja të duhanit që përdoren si terapi, por studimet shkencore nuk e mbështesin. Nëse prodhuesit thonë se duhet ta përdorin këtë produkt për terapi, unë them që kjo nuk duhet përdorur për popullatën e gjerë, duhet të përdoret brenda një ambienti, të themi spitali ose ndonjë qendër terapeutike, pra i kontrolluar. Në fakt, përdorimi i tyre duhet të jetë i përshtatshëm dhe t'iu nënshtrohet të gjitha kontrolleve dhe procedurave që iu nënshtrohen edhe barnat e tjera në mjekësi.

Pika e dytë është se nëse futet një produkt i ri i duhanit në treg, duhet të njoftohet Ministria e Shëndetësisë. Dua të bëj ndërhyrjen time edhe në këtë pikë. Roli dhe funksioni i Ministrisë së Shëndetësisë është të kujdeset për shëndetin e popullatës. “Më duket e pabesueshme”-, këto janë fjalët që përdor doktori që kjo të mos diskutohet. Pra, mund të futet një produkt i ri në treg, i tillë që të dëmtojë shëndetin e popullatës dhe ministria të mos njoftohet.

Tani do të flas për promovimin e produkteve të duhanit. Nëse e mbani mend në aktivitetet sportive vendosen tabelat e mëdha të duhanit. Unë jam pro asaj që zonja zëvendësministre tha që duhet ndaluar promovimi i duhanit gjithandej. Gjithashtu, e falënderoj, sepse zëvendësministrja përmendi edhe rastin e marketeve ku cigaret paketat e cigareve të janë vendosur në dollap para syve.

Të flasim tani për gjrobat. Që ligji të zbatohet duhet të ketë sanksione. Kjo është natyra njerëzore, pa sanksione nuk arrihet zbatimi i ligjit. Sllovenia ka kaluar një ligj kohët e fundit. Gjrobat atje janë shumë më të larta. Nuk besojmë se gjrobat në amendimin aktual të jenë problem.

Ju po thoni që niveli i lartë i gjrobave rrit ryshfetin që merr inspektori. Kjo nuk është e vërtetë. Korrupsioni duhet të luftohet si i tillë në të gjitha nivelet, nuk mund të merret si bazë thjesht për të vendosur gjobën, të paktën në këtë rast. Në çdo nivel të jetës, kur shikojmë korrupsion kemi detyrën ta denoncojmë.

Kemi dëgjuar edhe një fjalë në vendet ku ka kaluar ligji, që është ndikimi i ligjit në bizneset që kanë ambientet e jashtme, siç u tha.

Unë mund të them që kjo është fare e pavërtetë. Në vende si Spanja ose Franca kur populli intuitivisht mori vesh që në atë ambient nuk mund të pihej fare cigare, nuk është se e la kafënë. Në rastet kur klienti ka nevojë të pijë duhan, del në rrugë. E pi dhe futet brenda. Kjo nuk ka ndikuar fare në bizneset atje, ai vazhdon ta pijë.

Gjithashtu, diçka tjetër është vendosja e akcizës. Thuhet “pse duhet të vihet akciza e cigares nëse ato futen kontrabandë në Shqipëri”? Po ky është argument qesharak, sepse po e

brendësojmë ekzistencën e kontrabandës. Nëse kontrabanda ekziston është detyrë e Ministrisë së Brendshme ta luftojë atë.

Puna e Ministrisë së Shëndetësisë është të zhvillojë ligje progresive për të mbrojtur shëndetin e popullsisë në çdo situatë.

Shqipëria duhet t'i zgjedhë vendet që do të ketë model. Mendojmë që në të ardhmen përdorimi i paketimit neutral të cigareve të jetë një nga masat që duhet të merret.

Ky ligj po zbatohet tani në Zelandën e Re, në Australi, në Britani, në Norvegji, kurse në vende të tilla të mëdha si Kanadaja, ligji ka kaluar dhe po pritet zbatimi i tij.

OBSH –ja mbështet fort nismën e Ministrisë së Shëndetësisë për këtë ligj dhe nëse keni nevojë për ndihmë ose pyetje gjithmonë do të keni qasje te ne.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Lorent Goldi – Jam përfaqësues i “Filip Morris” në Shqipëri.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderojmë për mundësinë që na dhatë për t'u shprehur në këtë komision!

Ky projektligj, siç u tha edhe nga zonja zëvendësministre, është diskutuar në disa tryeza të rrumbullakëta ku ne kemi ngritur shqetësimet tona, dhe diskutimet kanë qenë të frytshme. Sot do të ngremë disa prej atyre probleme që kemi ngritur si shqetësime që në fillim.

Unë do të doja të sillja në vëmendje që sot OBSH-jë thotë që deri në vitin 2030 do të ketë 1 miliard duhanpirës në botë, numër i cili nuk ndryshon shumë nga sot. Me të gjitha masat dhe kontrollet që janë bërë, ne nuk shikojmë që trendi rënës i duhanpirjes të jetë i mjaftueshëm për të mbrojtur shëndetin publik. Për shumë vite për shkak të produktit kontraversal që shesim, ne jemi sulmuar dhe na është bërë thirrje me miliona herë që produktet të jenë më pak të dëmshme, të ulët riskun. Sot kjo ditë ka ardhur. Pas miliona e miliarda dollarësh të investuara nga të gjitha kompanitë serioze në botë, sot kemi produkte të cilat i ulin toksinat e tyre deri në 95% krahasuar me cigaret e zakonshme. Kur flasim për shëndetin publik është rasti të flasim edhe për ata që e pinë duhanin. Në Shqipëri, sipas OBSH-së 797 e 840 persona pinë duhan. A meritojnë këta persona që të kenë një mundësi tjetër, apo ose lër duhanin ose vdis? Jemi në një situatë ku duhet të merren parasysh edhe këta njerëz, që, me gjithë dëshirën e mirë, me gjithë njohuritë e mëdha që kanë për dëmet që sjell duhani, nuk arrijnë dot ta lënë atë. OBSH-jë fokusohet vetëm në

implementimet ligjore. Sigurisht një fazë e rëndësishme në lënien e duhanit është të ofrojë ndihmë për të lënë duhanin, të bëjë fushata ndërgjegjëse për lënien e duhanit ose mosfillimin e tij dhe sigurisht është edhe kërkesa për zbatimin e ligjit.

Unë mendoj se këto masa janë shumë të mira. Për herë të parë ulem në një tavolinë me përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të OBSH-së, ku unë shikoj se nuk kemi ndasi të mëdha në atë që po kërkojmë të bëjmë, implementimin e modelit anglez, i cili përmes planit për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit merr përsipër që të gjithë njerëzit që pinë duhan me djegie sot, t'i kalojë në një fazë me më pak dëm dhe pastaj të marrë masa rreth produkteve, që siç po e diskutojmë, janë 5% krahasuar me produktet me djegie.

Ne në pikat tona nuk është se kemi ndasi të mëdha, por do të ftoja përfaqësuesit e OBSH-së dhe të Ministrisë së Shëndetësisë që jetojnë këtu, të shikojnë se me çfarë situatash përballemi çdo ditë.

Në lidhje me situatën e tregut të duhan-cigareve në Shqipëri, sot kemi prezent 95% të tregut formal, duhet ta theksojmë tregut formal, sepse një konkurrent ende më i madh për ne është duhani që vjen nga tregtia e paligjshme. Dua të falënderoj Ministrinë e Bujqësisë dhe Sipërmarrjes, të cilat po punojnë në këtë drejtim për të përforcuar këtë ligj.

Unë prisja të dëgjoja sot një propozim nga përfaqësuesit e OBSH-së, protokollin për tregtinë e paligjshme të duhanit. Vetë OBSH-ja e ka parë si të nevojshme që të ndërhyjë dhe të vendosë një konventë dhe një protokoll, që parandalojnë këtë shitje duhani. Pra, jemi në fazën që duhet ta luftojmë, kjo është një fazë të cilën të gjithë së bashku duhet ta luftojmë dhe të mbrojmë shëndetin nga këto produkte. Siç u tha dhe më parë, këto produkte janë jashtë çdo kontrolli, prodhohen në kushte jashtëzakonisht mizerabël dhe sjellin dëme ende më të mëdha në shëndet. Të gjithë jemi dakord që duhani bën dëm, por produktet e pakontrolluara sjellin dëme ende më të mëdha.

Do të doja të ndalojë edhe të një qëndrimi i përfaqësuesve të OBSH-së në Shqipëri sipas të cilëve produktet e duhanit tradicionalet ose të reja duhet të trajtohen njëllë.

Në konferencën e palëve të konventës kuadër për kontrollin e duhanit në Gjenevë në vitin 2018, shtetet anëtare arritën një vendim për produktet e reja dhe në zhvillim të duhanit, të cilat duhet të monitorohen, të ngrihet një grup pune. Në këtë rast edhe vetë OBSH-ja ka ndasi të mëdha brenda vetes. Edhe në konferencën e tyre për shtyp duket haptasi që nuk dinë ose nuk janë të qartë si ky produkt duhet rregulluar. Në ligjin aktual njëra nga pikat për të cilat ne sot jemi mbledhur

është ajo për mos përdorimin brenda. Ndërsa sa i përket produkteve të reja, ne nuk e kuptojmë arsyen pse këto produkte të reja nuk duhet të lejohen në ambiente dhe restorante ku audienca është madhore, merr një vendim për të frekuentuar një bar të caktuar ose jo. Ju kujtoj këtu se po flasim për klube nate, kazino, pika, të cilat e filtrojnë audiencën e tyre që në hyrje.

Faleminderit!

Fatmir Kazazi – Unë jam konsulent i importuesve të duhanit i kompanisë “Filip Morris”, por edhe i Bashkimit Tregtar Shqiptar, që mbulon rreth 15 mijë biznese që shesin, ndër të tjera, edhe cigare në mbarë vendin.

Jam plotësisht dakord me shumicën e parafolësve, përfshirë OBSH-në. Ajo që më shqetëson shumë është që situata nuk duhet trajtuar bardh e zi. Nuk do të isha në asnjë mënyrë dakord të them se është argument qesharak se rritja e akcizës nuk e konsumon duhanin. Kjo për mendimin tim është e gabuar, sepse është provuar në historinë qindra vjeçare botërore, ekziston edhe një kurbë që studiohet në universitete dhe që quhet “kurba e Laferit”, sipas së cilës kur taksa rritet mbi një nivel të caktuar që nuk mund ta përballojë tatimpaguesi, bie formaliteti dhe devijohet tregu drejt paligjshmërisë. Ky rrezik është i provuar në Shqipëri edhe me duhan-cigaren. Sipas mendimit tim, hapi i parë që duhet bërë është analizimi i situatës. A duhet të vëmë në zbatim ligje më të forta dhe pa dashje të devijojmë tregun drejt konsumit të paligjshëm?

Unë dëgjova këtu disa objektiva sipas të cilave në vitin 2021 do të bjerë në 20% duhanpirja. Por unë nuk di një vend në botë që të jetë provuar kjo. Nuk ndodh, sepse nuk ka ndodhur në asnjë vend, por ajo që mund të ndodhë është devijimi i tregut drejt tregtisë së paligjshme. Të ishte problemi kaq i lehtë do ta kishte zgjidhur Zvicra dhe Gjermania. Zvicra e kontrollon territorin 100% do ta kishte shumë të lehtë ta bënte një paketë cigare 200 euro ose 500 euro, ta pinin vetëm ata që janë milionerë, sepse kanë mjetet mbrojtëse ndaj kancerit. Kjo nuk realizohet dot, do të lulëzonte tregu i paligjshëm. Pra, kur do të rritesh çmimin analizohen konsumatorët se cilët janë, a kanë mundësi ata ta blejnë. Gjithë do të kishin dëshirë ta linin duhanin, por a do ta linin dot ata nëse ne do t; miratojmë një ligj që ndalohet duhani komplet. Ne nuk duam të shohim paketat e duhanit në supermarkete, por në Shqipëri 20-30 e popullsisë furnizohet në supermarket, 70% në tregje të hapura në rrugë. Si e merr informacionin Ministria e Shëndetësisë për tregjet e hapura? Pra, shqetësimi më i madh është të analizohet tregu dhe të mbrohet shëndeti. Nëse unë shumë lehtë mund t’jua provoj që operatori numër 1 i duhan-cigareve në Shqipëri janë furnitorët e paligjshëm, atëherë si do t’i trajtojmë ne këto? A do të vazhdojmë të rrisim akcizën? A do të vazhdojmë të

rrisim gjokat? A bëhet buxheti me gjoka? Pra kjo është një pikëpyetje e madhe. Ne të gjithë biem dakord për këtë, por mënyrat që zgjedhim, nuk mendoj se janë më të duhurat.

Unë jam shumë dakord që ne të bëjmë një ligj i cili të jetë i zbatueshëm, por fakti që ky ligj adreson vetëm operatorët e ligjshëm mua nuk më pëlqen, për duhet që Inspektorati të vizitojë tregjet e bashkisë, ku paguhet vetëm taksa e bashkisë dhe shitet duhan, bëhet reklamë, shiten cigare të hapura, por të gjitha janë pa paguar taksat.

Aksioneri numër 1 në industrinë e duhan-cigareve është shteti. Në çdo paketë cigare që shitet formalisht shteti merr 70-80 %. Pra, kompanitë e cigareve marrin 25% dhe mbulojnë edhe kostot. Pra prioriteti i shtetit duhet të jetë si të formalizohet tregu, si të mblidhen të ardhurat, si të bindim njerëzit që ta pakësojmë konsumin, por jo t'i vendosim gjoka, sepse kompanitë e cigareve mund t'i ndalojmë edhe me ligj që të mos sjellin cigare, por çfarë do të ndodhë pastaj? Do t'i hapet rruga tregut të paligjshëm. Ne duhet të jemi të arsyeshëm të marrim modelin që na duhet, me qëllim që t'i shërbejmë popullatës.

Faleminderit!

Niko Peleshi – Faleminderit!

Përparim Dyshaj – Unë kam lindur në një fermë duhani dhe kam pothuajse të gjithë jetën që merrem me duhanin. Ne jemi qytetarë të këtij vendi dhe kemi objektiva të njëjta me Ministrinë e Shëndetësisë, Kuvendin për të mbrojtur jetën e njerëzve.

Unë mendoj se ligji aktual ka arritur shumë, por në ligjin aktual nuk është vetëm thjesht duhanpirja, sepse ka 20 nene, pjesa më e madhe e të cilëve është e zbatueshme në përditshmërinë e punës që bëhet në terren. Ligji aktual ka arritur shumë objektiva që i ka vendosur vetes Ministria e Shëndetësisë. Kur vjen puna sa i takon duhanpirjes si kompani, ne përpiqemi të mos prononcohemi, sepse i takon shtetit të vendosë ligjet nëse do të lejoj duhanin në një vend ose jo.

Unë do të ndalem në dy-tri momente, të cilat mendoj se duhen riparë dhe për të cilat jemi pjesërisht dakord me Ministrinë e Shëndetësisë.

Një nga pikat që ne mendojmë se duhet të rishihet është që në ambiente të veçanta të lejohet konsumimi i produkteve të reja të duhanit. Këto ambiente të kenë licencë nga Ministria e Shëndetësisë, të bazuar në kushtet që përcakton Këshilli i Ministrave. Gjithashtu, ne mendojmë të jenë qartësisht të përcaktuara vendet ku lejohet pirja e produkteve të reja të duhanit. Kjo do të ndikojë tek turizmi, sepse, për shembull, vende si Kroacia ose Mali i Zi, që e kanë të zhvilluar turizmin, e kanë praktikuar, madje Kroacia është drejt asaj që në bregdet të lejojë konsumin total

të duhanit, jo vetëm të produkteve të reja, sepse ka 8-10 milionë turistë në vit, të cilët përveç gjërave të tjera duan të pinë duhan.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në ambiente të veçanta, siç e thashë më përpara, pra ku të lejohet duhanpirja. Në mbështetje të kësaj, ne mendojmë që përkufizimi i duhanit duhet të mbetet siç është në ligjin aktual.

Së dyti, në draftligj ne kemi punuar shumë sa i takon nenit që përcakton nenin 13 të ligjit aktual, sa i takon përdorimit të promociioneve të fshehta, siç e përmendi zëvendësministria. Ne mendojmë që rishikim i vogël duhet bërë, i cili e përcakton qartë heqjen e çdo lloji mundësie për keqinterpretime, siç u fol më parë, për sjelljet e inspektorëve e të tjera. Ne mendojmë që kjo duhet të bëhet: “Ndalohet promovimi dhe reklamimi indirekt i produkteve të duhanit nëpërmjet logove dhe markave të regjistruara të produkteve të duhanit. Produktet e duhanit mund të paraqiten në pikat e shitjes vetëm në paketimet e tyre origjinale”. Pra, ky është një përcaktim i qartë se çfarë është e ndaluar. Po kështu, duke shtuar: “...produktet e duhani vetëm në paketimin e tyre origjinal” heqim çdo mundësi që të ketë çfarëdo lloji fotografie që mund të imitojë një paketë duhani. Kjo është pika e tretë që ne kemi menduar të rishihet.

Kemi edhe diçka tjetër për paraqitjen e shijeve të ndryshme që lejohen. Është e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, meqenëse këto ndalohen, ne mendojmë të mos jetë si pikë te paragrafi i dytë i nenit 6, por nëse Ministria e Shëndetësisë do që të jetë, për ne nuk ka problem.

Falënderojmë ministrinë që janë marrë me këtë projektligj. Për mendimin tim, ky është një nga draftligjet për të cilin është punuar më shumë. Ne jemi ulur në tavolinë dhe kemi diskutuar për të gjitha pikëpamjet tona.

Faleminderit!

Niko Peleshi- A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

A ka komente?

Po, zoti Konomi.

Ardit Konomi – Në tërësi ky projektligj nuk cenon asnjë të drejtë të duhanpirësve dhe as nuk i diskriminon, siç u pretendua në disa raste, por ne duhet të mbajmë edhe interesat e atyre që nuk pinë duhan. Duhani duhet parë edhe si një çështje sociale, përtej dëmit shëndetësor që sjell, problem që lidhet me të qenit vegjetativ, të qenit joaktiv dhe me krijimin e disa habiteve, të cilat pak nga pak të largojnë nga pjesa aktive e të jetuarit dhe ky është një problem social. Unë kam bindjen që ne duhet ta miratojmë projektligjin.

Niko Peleshi – Faleminderit!

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord në parim për projektligjin? Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.
Miratohet.

Kalojmë në diskutimin nen për nen.

Neni 1 që ka edhe 36 përkufizime, ku janë shtuar edhe produktet novatore.

Një nga përfaqësuesit e grupeve të interesit propozon që përkufizimi për pirjen e duhanit të mbetet i pandryshuar: Pirje duhani është ndezja, thithja dhe mbajtja në dorë e ndezur e çdo produkti duhani që digjet”. A keni ndonjë opinion, propozim ose mendim tuajin alternativ?

Atëherë kush është dakord me neni 1, sipas variantit të Këshillit të Ministrave? Kundër?
Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2, sipas variantit të Këshillit të Ministrave. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3, sipas variantit të Këshillit të Ministrave. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3, sipas variantit të Këshillit të Ministrave. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3, sipas variantit të Këshillit të Ministrave. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 3, sipas variantit të Këshillit të Ministrave. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka.
Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë te neni 7. Fjalja e fundit e paragrafit të parë të nenit 13 të ndryshohet si më poshtë:
“Ndalohej promovimi dhe reklamimi indirekt i produkteve të duhanit nëpërmjet logove dhe markave të regjistruara të produkteve të duhanit. Produktet e duhanit mund të paraqiten në pikat e shitjes vetëm në paketimin e tyre origjinal”. Ndërkohë që në nenin 7 sipas variantit të Këshillit të

Ministrave thuhet: “Ndalohej çdo lloj forme tjetër reklamimi e produkteve të duhanit, përfshi promocionin indirekt përmes ngjyrave që përfaqësojnë logot e kompanive ose promocioni nëpërmjet ekspozimit të produkteve që imitojnë paketimin e jashtëm të një produkti duhani”.

Atëherë, kush është dakord me variantin e Këshillit të Ministrave?

Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 8, sipas variantit të Këshillit të Ministrave. Kush është dakord?

Kundër? Nuk ka. Abstenime? Nuk ka.

Miratohet.

Unë jam dakord personalisht me rritjen e sanksioneve, por a duhet të shkojmë deri te pezullimi i aktivitetit, deri në shlyerjen e masës së gjobës? Nëse pezullohet një aktivitet për disa javë ose muaj është shumë e vështirë ta rikthesh.

Unë personalisht mendoj se nuk duhet të shkojmë deri në pezullim aktiviteti. Argumenti që kam, por nuk insisto, do të jem dakord me shumicën, po nuk ia dola do të tërhiqem. Biznesi është person juridik më vete, ka personalitet juridik më vete, nuk ka personalitetin e pronarit, nëse ti ndëshkon pronarin me gjobë me sanksione në rritje, nuk ke pse ndëshkon edhe biznesin, si personalitet, në kuptimin që ta mbyllësh. Ky është argumenti që kam, sepse nuk është kollaj të mbyllësh një aktivitet, pastaj pas tre muajsh ta hapësh prapë.

Kujtim Gjuzi – Të marrim një shembull, në një iks bar, unë nuk do të doja të pihej duhan, sepse edhe vetë nuk jam duhanpirës, por pronari i barit do që në bar të hyjnë ca njerëz që pinë duhan, sepse i duhet klientelë.

Ky është konflikt, pasi në Tiranë ka bare elitë, në të cilat shkon dhe pi duhan dhe bën çfarë të duash. Në njërin që shkova dhe iu thashë se pse pihet duhan këtu, më thanë të mos shkoja më, se nuk kishin nevojë për klientë të tillë.

I nderuar, kryetar po nuk qemë radikal, kjo punë nuk bëhet.

Faleminderit!

Ardit Konomi – Neni 8 që ndryshon nenin 20 duhet ta shohim në tërësinë e tij. Pra, bëhet fjalë për një aktivitet, i cili në mënyrë të përsëritur kapet në shkelje të kësaj pike, pra gjobitet herën e parë, të dytën, e të tretën dhe në fund, nëse kjo është shkelje e përsëritur, e kthyer në ves, të mendohet mbyllja e aktivitetit. Megjithatë, parimisht, unë jam kundër mbylljes së aktivitetit. Unë jam për rritjen e gjobës, pra ta dënojmë nga ana administrative, por jo me mbylljen e aktivitetit.

Niko Peleshi- Gabimi është që ne ngatërrojmë pronarin me biznesin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mira Rakacolli - Ne kemi diskutuar dhe debatuar kur kemi bërë hartimin e këtij projektligji. Arsyeja e vendosjes për mbylljen e biznesit, megjithëse është marrë parasysh edhe këndvështrimi i prezantimit të biznesit, ka dalë nga që ata nuk e paguajnë gjobën. Pra, ashtu siç iu tha edhe nga deputeti është lënë një hapësirë, është lënë brenda vitit për herë të tretë. Nëse dikush e ka lexuar ligjin, e shkel herën e parë, e shkel të dytën dhe prapë të tretën, atëherë duhet t'i mbyllet biznesi.

Niko Peleshi - Ju lutem, konsideroni një biznes që ka 10 pronarë, një shoqëri aksionere, ka të punësuar një administrator, i cili nuk e menaxhoi siç duhet dhe mori tri gjoba, por pse duhet t'i mbyllet aktiviteti pronarit?

Prandaj këto quhen shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, sepse përgjegjësia është e kufizuar te pjesa e kontributit dhe e aksioneve, por jo të shkatërrohet biznesi. Biznesi është person tjetër, nuk është pronari. Pronari mund ta keqpërdorë biznesin e vet, por ai si biznes ka personalitetin e vet.

Faleminderit!

Propozoj që neni 8 të qëndrojë siç është, me përjashtim të fjalës “pezullim i aktivitetit”. Pra, të heqim fjalët “pezullim i aktivitetit”.

Kush është dakord që të hiqen fjalët “pezullim i aktivitetit”.

Kundër?

2 kundër? Abstenime?

Nuk ka.

Miratohet ky nen me ndryshimin sipas të cilit hiqen fjalët “pezullim i aktivitetit”.

Neni 9. Kush është dakord me variantin e Këshillit të Ministrave?

Kundër? Nuk ka. Abstenime?

Nuk ka. Miratohet.

Hedhim në votim në tërësi projektligjin.

Kush është dakord në tërësi?

Kundër? Nuk ka. Abstenime?

Nuk ka.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA